



Sipas Kryetarit të Komunës Mavrovë-Rostushë, Mukrem Mehmedi, qëllimi i këtij manifestimi është promovimi i rajonit dhe zhvillimi më i shpejt i turizmit rural. Ai njëkohësisht ka ftuar mysafirët që të vijnë në numër edhe më të madh edhe gjatë verërave të ardhshme

Pensionistët nga Gjorçe Petrovi në Pitiadë në Jançe "Pitiada 2017", manifestimi më i suksesshëm deri tani



Manifestimi "Pitiada 2017" që organizohet nga vetëqeverisja lokale në Komunën Mavrovë-Rostushë, çdo vit ditë e më shumë bëhet me i vizituar. Në zgjedhjen e pites më të mirë sivjet kanë marrë pjesë mbi 50 amvise, Kështu që "Pitiada 2017" ishte një prej më të suksesshmeve gjatë dhjetë viteve. Manifestimi është pjesë e Programit "Vala verore turistike" e Komunës Mavrovë-Rostushë, ndërsa sivjet e vizituan edhe një grup i pensionistëve nga Komuna Gjorçe Petrov, të cilët falë nikoqirëve mikpritës, patën mundësinë të përcjellin aktivitetet rreth përgatitjes së pites nga Reka, por edhe njëkohësisht të shijojnë 50 pite të përgatitura nga amviset e fshatrave të Rekës: Velebrdo, Rostushë, Jançe, Skudrinjë dhe vendbanime të tjera të Rekës së Poshtme. Kryetari i Shoqatës së Pensionistëve nga Gjorçe Petrov, Metodija Novkovski, thotë se kjo është mënyrë e mirë që pensionistët

të shohin këto vende të bukura të shtetit tonë, dhe njëkohësisht të shoqërohen me pensionistët e kësaj ane.

"SHP Gjorçe Petrov vazhdimisht organizon udhëtime turistike, ndërsa në kuadër të asaj është edhe kjo vizitë në Komunën Mavrovë-Rostushë. Të gjithë jemi shumë të kënaqur që sot në këtë ditë të bukur verore, kemi

mundësinë të shijojmë pamjet e bukura të Rekës së Poshtme dhe pites të shijshme", u shpreh kryetari i SHP Gjorçe Petrov, i cili është njohës i mirë i kësaj ane dhe rajonit të Dibrës prej nga edhe ka prejardhjen. Ai, në aktivitetin e tij si publicist, ka shkruar dhe libër edhe për fshatin e tij të lindjes Xhepishte. Për ndryshe, "Pitiada 2017" lartë e

kanë vlerësuar edhe pensionistët tjerë të pranishëm nga Komuna Gjorçe Petrov. "Shija e pites nga ky rajon është shije e traditës", deklaroi Aziza Asanoska, udhëheqësja e organizatës joqeveritare të grave "Radika", që është e lindur në këto anë.

Sipas Kryetarit të Komunës Mavrovë-Rostushë, Mukrem Mehmedi, qëllimi i këtij manifestimi është promovimi i rajonit dhe zhvillimi më i shpejt i turizmit rural. Ai njëkohësisht ka ftuar mysafirët që të vijnë në numër edhe më të madh edhe gjatë verërave të ardhshme.

"Komuna jonë vlerëson se shtylla e parë e zhvillimit të saj është turizmi, kështu që edhe ky manifestim është në atë drejtim", ka theksuar kryetari Mehmedi. Mysafirët të cilët kanë përcjellë këtë manifestim interesant në fshatin Jançe kanë vizituar edhe ujëvarat e bukura tek DUF dhe manastiri i grave "Shën Gjorgji Pobedonosic" në fshatin Rajçicë, ndërsa pensionistët e SHP Gjorçe Petrov të mahnitur nga ajo që panë premtuan se edhe verën e ardhshme do të vijnë sërish. (V.S)

Një klub i ri për pensionistët e Kërçovës

Këtyre ditëve, mbi 4500 pensionistë nga shoqata e pensionistëve të Kërçovës kanë fituar katin e tyre, klub të ri të pensionistëve. Klubi është i vendosur në Shtëpinë e Pensionistëve në Kërçovë në hapësira të renovuara, pronë e Shoqatës. Për renovimin dhe pajisjen janë shpenzuar mbi 270.000 denarë mjete vetanake. Kryetari i shoqatës, Lubomir Llukarowski, i kënaqur thotë se përfundimisht u plotësua dëshira e pensionistëve, të cilët për një kohë të gjatë kanë pritur këtë moment që të kenë klubin e tyre ku mund të kalojnë kohën e lirë me aktivitete të llojllojshme. Klubi posedon 10 tavolina me nga katër karrige ku mund të luhet shah, domino, tablo dhe letra, të lexohen gazeta, të shikohet televizor dhe të pushojnë dhe freskohen me kafe, çaj... Klubin e ri e vizitoi edhe kryetari i Lidhjes së Shoqatave të Pensionistëve të Maqedonisë, Dragi Argirovski. Ai lavdëroi mënyrën e ndarjes së mjeteve vetanake për përmirësimin e kushteve për jetesë të pensionistëve dhe premtoi se çdoherë, Lidhja do të ndihmojë për aktivitete të këtitilla dhe të ngjashme. Duke ju dhuruar orë muri, Argirovski u dëshiroi pensionistëve të Kërçovës shëndet dhe shoqërim të gjatë. Në klub mund të përgatiten dhe organizohen aktivitete dhe gara të pensionistëve, ndërsa aty anëtarët e Aktivit të pensionistëve çdo të enjte të fundit të muajit mbajnë takime dhe mbledhje. (A.R)

Pensionistët e Gostivarit me suksese të njëpasnjëshme

Shoqata e Pensionistëve nga Gostivari me përfaqësuesit e saj më 8 dhe 9 korrik ka marrë pjesë në Festivalin e 43-të të këngëve dhe instrumenteve popullore "Pece Atanasovski" në Dollnen të Prilepit. Në këtë manifestim kulturor ndërkombëtar, në të cilin morën pjesë 40 SHKA me mbi 600 artistë, grupi i pensionistëve të Gostivarit "Besa" mori pjesë me programin e vet dhe u prezantua në mënyrë mjaft të suksesshme. Me ezgji me kavalje morën pjesë Sala Shabani dhe Shefket Ismani, duke shfaqur një pjesë të kulturës dhe traditës shqiptare, për çka u



shpërblyen me diploma. Të shoqëruar me tingujt e këtyre kavallxhinjve me zërin e vet specifik dhe tërheqës - duartrokjetet më të fuqishme dhe më të gjata i mori Elena Jakimoska me

këngën "Aj dvorje mete mala Angjelina". Grupi i gostivarasve fitoi pesë diploma, prej të cilave një speciale për interpretimet e më shumë instrumenteve frymore dhe akustike. Mirënjoh-

ja "Skulptura e festivalit" u nda për zbulimin dhe punimin e instrumenteve të reja popullore folklorike, ndërsa "Besa" u shpall si grupi më i mirë multikulturor folklorik. Ky prezantim i suksesshëm i festivalit në Dollnen ishte edhe një sukses i rëndësishëm dhe vërtetim i kualitetit të grupit folklorik të pensionistëve nga SHP Gostivar e cila në dritën më të mirë u prezantua edhe në Revynë republikane të këngëve, muzikës dhe valleve 2017 në Shkup, ku la përshtypje të fortë me këngën "Një është Zoti, një është Allahu" dhe fitoi duartrokjetet më të fuqishme. (V.Z)



Takimi i pensionistëve nga Maqedonia tek kompleksi i manastirit në Pantelej



Mbi 2000 pensionistë nga 25 shoqata të pensionistëve nga e tërë Maqedonia, më 12 gusht morën pjesë në takim tradicional të pensionistëve të vendit, i cili për të 11-tën herë mbahet në kompleksin e manastirit "Shën Pantelejmon" në fshatin Pantelej të Koçanit. Në tubim, në emër të organizatorit - të pranishmit i përshëndeti kryetari i Shoqatës së Pensionistëve të Koçanit, Gjorgji Serafimov, ndërsa në emër të qytetit nikoqir - pensionistëve mirëseardhje dhe qëndrim të kënd-

shëm në këtë bukuri malore u dëshiroi kryetari i Koçanit, Ratko Dimitrovski. Të pranishmëve ju drejtua edhe kryetari i Lidhjes së Shoqatave të Pensionistëve të Maqedonisë, Dragi Argirovski, i cili theksoi unitetin e pensionistëve të vendit përmes takimeve të përbashkëta, shoqërimit dhe miqësisë dhe nevojën për vazhdim të rrugës së përbashkët drejt arritjeve të reja në interes të shfrytëzuesve të shumtë të pensionit në vendin tonë. Takimi në Pantelej filloji me këngën popullore

tradicionale të rrethit të Koçanit "Ajde red se redat koçanski semejmeni" të kënduar nga Canko Minov, ndërsa në programin kulturo-artistik mori pjesë ansambli folklorik nga SHP "Radovish" dhe "Konçe", i cili u prezantua me përzierje të këngëve dhe valleve të rrethit të Radovishit, me të cilat para dy viteve mori pjesë në takim ndërkombëtar tradicional të pensionistëve të gjeneratës së tretë në Lubjanë të Sllovenisë, duke përfaqësuar LSHPM dhe Maqedoninë. (K.G)